



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Phantom Solutions ShPK" të datës 31.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Phantom Solutions ShPK" të datës 31.08.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Phantom Solutions ShPK" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 31.08.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "100 Ndërtimi i sheshit Xhorxh Bush" me nr. të prokurimit 616-24-8261-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 – *“ne rastet kur ka njoftim paraprak, atehere tenderi duhet te jete i hapur ne nje afat jo me pak se 24 dite. Afati i fundit i caktuar nga Autoriteti Kontraktues eshte me i shkurter se 40 dite, dhe me i shkurter edhe se 24 dite”*.

Lidhur me këtë pretendim duhet sqaruar se për këtë aktivitet të prokurimit është publikuar njoftimi paraprak për kontratë. Megjithatë sipas nenit 44 dhe 45 të LPP përcaktohet se afati për dorëzimin e ofertave në aktivitetet e prokurimit për të cilat është publikuar njoftimi paraprak për kontratë, duhet të jetë së paku 24 ditë. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar në pikën ku thuhet se afati për dorëzim të ofertave nuk mund të jetë më pak se 24 ditë. Rrjedhimisht AK duhet të publikoj formularin për korrigjimin e gabimeve njoftimet e publikuara përmes të cilit do të bëj zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi nr. 2 – *“nder te tjera. E ndersa inxhinieri i radhes i ndertimtarise, drejtimi hidroteknike eshte kerkuar qe te kete certifikate per testim te tubacioneve EN805 W400, kerkese kjo qe nuk ka te beje me projektin, por aplikohet ne projektet e shtrirjes se ujesjellesit dhe tubave me presion. Per nje inxhinier tjeter eshte kerkuar qe te jete i certifikuar sipas ISO 9001. Ky certifikim eshte certifikate qe i leshohet kompanive per sisteme cilesore te menaxhimit, por nuk ka te beje me individet. Gjithashtu ne dosje te tenderit jane vendosur kerkesa si certifikate ISO 50001, ISO 3834 2. ISO 50001 eshte certifikim per menaxhimin e energjise, qe nuk ka asnje lidhshmeri te mundshme me projektin ne fjale. Gjithashtu ISO 3834-2 eshte certifikim per saldimin e metaleve, qe nuk ka asnje lidhshmeri me projektin ne fjale”*.

Lidhur me këtë pretendim duhet sqaruar se të gjitha kërkesat e DT sa i përket standardeve të cilësisë dhe/ apo certifikimet tjera përkatëse, janë hartuar me kujdes duke marrë parasysh kompleksitetin dhe natyrën e projektit. Në rastin konkret kërkesat për stafin e operatorit ekonomik tenderues janë të gjitha kërkesa apsolutisht të domosdoshme. Mospërmeshja e secilës prej tyre do të rrezikonte në mënyrë thelbësore jo vetëm cilësinë dhe nivelin profesional të projektit në fazën e implementimit, por edhe efikasitetin dhe efektivitetin e realizimit të projektit si të tillë. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Pretendimi nr. 3 – *“Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka kerkuar te dorezohen mostra, por nuk ka percaktuar se kur duhet dorezuar te njejtat”*.

Lidhur me këtë pretendim duhet cekur se mostrat dorëzohen me rastin e dorëzimit të ofertës para hapjes ndërsa Atestet dorëzohen me rastin e dorëzimit të ofertës në mënyrë elektronike përmes eprokurimit dhe/ apo me rastin e dorëzimit të mostrave.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar vetëm pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.09.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.